



OSBE-ja ndihmon raportimin e trafikuesve të qenieve njerëzore në Kosovë

Misioni i OSBE-së në Kosovë është duke e mbështetur një fushatë për të promovuar linjën telefonike për ndihmë kundër trafikimit. Qëllimi i kësaj fushate është të rrisë rrjedhën e informatave ndërmjet publikut dhe autoriteteve për të luftuar trafikimin me qenie njerëzore.

Sipas Richard Sondeijker, shef i njësisë kundër trafikimit pranë Misionit të OSBE-së në Kosovë, një nga problemet më të mëdha në luftimin e trafikimit është se shumë informata të vlefshme mbesin të fshehura.

“Njerëzit ngurrojnë të flasin për problemet që i prekin familjet e tyre,” tha ai “dhe për shkak se trafikimi ka një damkë të veçantë, anëtarët e familjes dhe fafesi parapëlqejnë të heshtin, edhe në rastet kur viktima është e tyre.”

Shënimet e policisë dhe të Organizatës Ndërkombëtare për Migrim tregojnë se 745 viktima të trafikimit janë identifikuar gjatë tetë viteve të fundit, por është vështirë të dihet numri aktual i viktimave pasi që shumë raste mbesin pa u raportuar.

Duke refuzuar të spekuloj në lidhje me numrin e rasteve, Arta Kelmendi nga Njësia për Avokim pranë Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës, thotë se për shumë familje të viktimave të shpëtuar, të pranosh se i afërmi i tyre është trafikuar për shfrytëzim seksual don të thotë të humbasësh krenarinë.

“Shpesh ballafaqohemi me mospranim nga familjet, sidomos në zonat rurale,” thotë Kelmendi. “Ndonjëherë ekspertët tanë duhet të punojnë me ndonjë familje dy apo tre muaj para se viktima e shpëtuar të kthehet në shtëpi, por e rëndësishme është që viktima të kthehet në shtëpi.”

Thyerja e heshtjes

Deri sa njerëzit heshtin dhe e mbajnë për vete, Sondeijker citon burime zyrtare nga Shtetet e Bashkuara dhe Komisioni Evropian që tregojnë se përpjesëtimi i viktimave të trafikuar brenda është duke u rritur. “Për këtë arsye ne kemi vendosur ta organizojmë këtë fushatë-t’ a ngrisim vetëdijen e njerëzve për këtë problem dhe t’i bëjmë që ata të flasin,” thotë ai.

Fushata informative, e cila ka filluar më 25 nëntor dhe do të zgjasë deri më 10 dhjetor, do të promovojë linjën për ndihmë të Ministrisë së Drejtësisë, ku në shënjestër janë të rinjtë , e në veçanti gratë.

“Ne duam që ata të flasin për ate që u ndodh atyre apo miqve të tyre dhe ta raportojnë informatën që e kanë tek autoritetet,” thotë Ariana Qosaj-Mustafa, Këshilltare Ligjore mbi të drejtat e grave dhe fëmijëve pranë Misionit të OSBE-së.

Duke përzgjedhur grupet më të popullarizuara të skenës muzikore të Kosovës, motoja e fushatës është ““Rock to break the silence! Report human trafficking!” Do të kulminojë me një koncert falas më 10 dhjetor 2008-me rastin e Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe të 60 vjetorit të Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut.

Ambasadorët kundër trafikimit

Gjatë fushatës, artistë që morrën pjesë në koncert do të jenë mysafirë në stacionet televizive dhe te radiove, duke përfshirë shërbimin publik të transmetimit, RTK, për të diskutuar mbi trafikimin dhe nevojën e shpërndarjes së informatave në lidhje me te. “Ne do të veprojmë si ambasadorë të vullnetit të mirë,” thotë këngëtarja Flaka Krelani. “Ne do të jemi lajmëtarë.”

“Jam caktuar të jap një intervistë për emisionin e televizionit të RTK-së “*Amazing be njeri*”, thotë ajo. “Porosia ime do të jetë që vajzat ta përkrahin njera tjetrën. Edhe nëse familjet tona nuk na përkrahin, ne duhet të jemi aty pranë njera tjetrës.”

Shoku i saj Guri Shkodra, kitarist në grupin “Gillespie” do të jetë mysafir në TV21. “Do t’u flas edhe të rinjve edhe institucioneve,” thotë ai. “Ne të gjithë dimë nga diçka dhe duhet të flasim. Institucionet duhet të bëjnë publike atë çka dinë dhe të jenë më konkret kur merren me këtë problem.”

Marrja në shtëpi

Misioni i OSBE-së u ka siguruar të gjithë artistëve informata shtesë mbi trafikimin dhe është duke aranzhuar paraqitjen e tyre para mediave. “Ajo për çka duam që njerëzit të jenë posaçërisht të vetëdijshëm është se sot më shumë se gjysma e viktimave të trafikimit në Kosovë janë në të vërtetë nga Kosova,” thotë Sondeijker.

“Çka është më edhe shumë brengosëse është se në shumë raste të cilat janë trajtuar nga policia apo autoritetet, trafikuesit ishin persona që viktimat i njihnin, si të afërm apo dashnorët e tyre.” Nga 139 rastet e lajmëruara dhe të adresuara gjatë tre viteve të fundit, 60 raste ishin trafikim i brendshëm në Kosovë.

“Është e rëndësishme t’i marrësh në shtëpi,” thotë Sondeijker, në frymën e koncertit të ardhshëm. “Kjo fushatë do të zgjasë vetëm dy javë, por ne shpresojmë t’i arrijmë të rinjtë dhe ti nxisim të fillojnë të flasin, në mënyrë që ti lëvizin sendet në drejtimin e duhur.

Shkruar nga Nikola Gaon